



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

## Shpall

# K O N K U R S të brendshëm

**për plotësimin e vendeve të lira të punës**

**TEKNIK NË ENERGETIKË / PRODUKSIONI DHE TEKNOLOGJIA / NJËSIA E ENERGETIKËS /  
RTK-RADIO 1 POZITË (Nr. 1534)**

### Detyrat

- Përkujdeset për punën korrekte të aparaturës energjetike, të ndriçimit dhe klimatizimit;
- Përkujdeset për furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike.
- Përkujdeset për punën e gjeneratorëve dhe UPS-ve.
- Mirëmban dhe servison gjeneratorët;
- Monitoron punën e UPS-ve;
- Kryen intervenime të nevojshme në instalimin elektrik sipas nevojës gjatë ndërrimit dhe sipas udhëzimeve nga inxhinieri përgjegjës në energjetikë;
- Përkujdeset për kyçjen dhe shkyçjen e pajisjeve në punë;
- Zbaton me përpikëri detyrat nga skema e mirëmbajtjes;
- Merr pjesë në instalime të reja të rrjetit dhe aparaturës energjetike;
- Bashkëpunon me kompaninë e distribucionit rreth mirëvajtjes së furnizimit me energji elektrike;
- Përkujdeset për ndriçim të objekteve, zyrave, hapësirave punuese dhe studiove;
- Në rastet kur ka ndërprerje të furnizimit kujdeset për kyçjen dhe shkyçjen automatike/manuale të gjeneratorëve.
- Përkujdeset për stabilizatorin e frekuencës dhe trafon e tensionit 10KV;
- Sipas nevojës, ngjitet në lartësi për intervenime dhe sanime të rrjetit elektrik;
- Mban raporte të rregullta ditore të punës;

### Kushtet

- Kualifikim të mesëm profesional, drejtimi i energjetikës do të konsiderohet përparsi;
- Së paku një vitë përvojë pune në punë të ngjashme;
- Njohje e rregullave dhe standardeve në lëmin e energjetikës;
- Aftësi për punë në lartësi;
- Aftësi për punë me tension të lartë;
- Aftësi për të punuar me ndërrime dhe me orar të zgjatur;
- Aftësi për të punuar qetë, nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetiniciativë.

**TEKNIK I ZËRIT 2 / PRODUKSIONI DHE TEKNOLOGJIA / INCIZIMI DHE MONTIMI /  
RTK-RADIO 1 POZITË (Nr. 1558)**

### Detyrat

- Punon në ndërrime, në emetim dhe incizim të programit, si në studio ashtu edhe në terren;
- Është përgjegjës për kualitetin teknik të programit të emtuar dhe të incizuar;
- Është përgjegjës për ruajtjen e incizimeve në folderët përkatës të raporteve të korrespondentëve, gazetarëve, emisioneve të incizuara dhe incizimeve të tjera;
- Kujdeset që të bëjë pastrimin e hard disqeve nga file-at e vjetër dhe të panevojshëm si në studiot e emetimit ashtu edhe në ato të incizimit;

- Kujdeset për kyçje dhe shkyçje të switch-it në teknikë kryesore në kohë kur është në ndërrim për transmetimin e programeve si dhe kyçjeve në rastet e problemeve teknike, sidomos të atyre gjatë mungesës së rrymës;
- Sipas nevojës, në rastet e urgjencës intervenon edhe në problemet teknike për të cilat ka njohuri dhe për të cilat urdhërohet nga udhëheqësi i tij;
- Kujdeset për vendosjen e lidhjeve për transmetim.

#### **Kushtet**

- Kualifikim të mesëm profesional;
- Së paku gjashtë muaj përvojë pune në punë të ngjashme;
- Njohje e shkëlqyer e punës me kompjuter;
- Të ketë përvojë me software si Sound Forge dhe Cool Edit;
- Njohuri e gjuhës angleze;
- Aftësi për të punuar me ndërrime dhe me orar të zgjatur;
- Aftësi për të punuar qetë, nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetiniciativë.

*Për këto vende të punës është e paraparë kontrata e punës me kohë të caktuar në afat 3(tre) vjeçar (ose varësisht nga lloji i kontratës i kandidatit të përzgjedhur), me periudhë provuese 6 mujore.*

#### **Kandidatët e paraqitur për këtë pozitë duhet:**

- të jenë qytetar të Kosovës - regjistruar sipas dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi.

#### **Kandidatët duhet të dorëzojnë:**

- ✓ një CV;
- ✓ dëshmitë e kualifikimit të noterizuara;
- ✓ një kopje të letërnjoftimit;
- ✓ një letër motivuese;
- ✓ dy referenca;
- ✓ dëshmi të përvojës;
- ✓ dëshmi nga Gjykata që nuk janë dënuar me vendim të plotëfuqishëm për vepër penale të dënueshme më shumë se gjashtë muaj (të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit);
- ✓ aplikacionin i cili duhet të shkarkohet nga ueb-faqja e RTK-së: <https://www.rtklive.com/sq/docs/2022-02-05/231.doc>

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes e-mail adresës: [konkursradio@rtklive.com](mailto:konkursradio@rtklive.com), prej 22.05.2023 deri më 05.06.2023 (ora 23:59).

**Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.**  
Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merren në konsiderim.